



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.402, datë 19.12.2023

PËR

**“NGRITJEN E KOMISIONIT TË PËRKOHSHËM PËR SHQYRTIMIN E ANKIMEVE KUNDËR VENDIMEVE TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, PËR ARKIVIMIN E ANKIMIT OSE PUSHIMIN E HETIMIT DISIPLINOR NDAJ NJË PROKURORI”**

Bazuar në nenet 160 pika 13, 164, 166 pika 2, 189, të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit disiplinor ndaj një prokurori.
2. Komisioni do të përbëhet nga tre anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë të zgjedhur me short në seancën plenare të datës 19.12.2023, si më poshtë:
  - i. Zoti Sokol Stojani
  - ii. Zonja Arta Mandro
  - iii. Zonja Mirela Bogdani
3. Kryetar i Komisionit caktohet zoti Sokol Stojani.
4. Komisioni do të ushtrojë kompetencat e tij për shqyrtimin e ankimeve sipas përcaktimeve të nenit 160 pika 13, të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, për dy vite e gjysëm nga sot.
5. Ky vendim hyn menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më 19.12.2023.

KRYETAR

Alfred Balla

